



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
GRUPI I PUNËS PËR HARTIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
PËRLLOGARITJEN E FONDIT LIMIT

Nr. _____ Prot.

Shijak, më _____._____.2025

SPECIFIKIME TEKNIKE

Shërbimi i pastrimit të territorit administrativ të Bashkisë Shijak është detyrë e rëndësishme dhe me efekte të dukshme ,të prekshme nga qytetarët ndaj që realizimi i tij të jetë sa më i sukseshshëm duhet të llogariten shërbimet më kryesore dhe me ndikim te banorët, në mënyrë që të realizohen nevojat e territorit me shërbim pastrimi duke pasur parasysh specifikat e Bashkisë Shijak

Aktivitetet që do të kryhen për pastrimin e territorit të Bashkisë Shijak:

1. Mbledhja ,grumbullimi dhe transporti I mbetjeve urbane për në Landfillin e Sharrës.
2. Larje dhe dezinfektim i kazaneve dhe hapsirave publike
3. Fshirja me fshesë e rrugëve,trotuareve dhe shesheve gjatë ditës dhe natës
4. Lagje rrugesh dhe sheshesh gjate muajve Korrik-Gusht
5. Mirëmbajtje te sipërfaqeve te gjelberta dhe drureve me lartesi 1.5 m.
6. Mirëmbajtje e varrezave dhe ofrim I shërbimit të varrimit .

1.GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTIMI I MBETJEVE URBANE .

VOLUMET E PUNIMEVE

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendosjen e **341** kontenierëve me volum 1.1 m3, brenda zonës së kontraktuar. Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji, **341** zbrazeje kontenierësh/ditë.

Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në qytetin e Shijakut dhe Njësi Administrative. Të gjithë kontenieret do të sigurohen nga autoriteti kontraktor dhe mirëmbajtja dhe siguria e kontenierëve do të kryhet nga kontraktori.

SPECIFIKIME TEKNIKE DHE METODOLOGJIA

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve urbane konsiston në:

a. Zbrazjen e kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar në preventiva 10 ton dhe 5 ton, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth,dezinfektimin e zones rreth kontenierit, pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre.

b. Në çmimin njësi të largimit të mbeturinave urbane përfshihet gjithashtu edhe dezinfektimi në përfundim, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda dhe jashtë zones përreth çdo kontenieri. Mund të bëhet dezinfektimi ditor, pas zbrazjes së çdo kontenieri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

PLANI I VENDOSJES SË KONTENIERËVE DHE GRAFIKËT E PUNIMEVE

- a. Autoriteti kontraktues ka përcaktuar në fillim të kësaj kontrate pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve urbane, dhe numrit të kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kontraktuar ku përfshihen edhe të gjitha pikat e grumbullimit pranë të gjitha tregjeve brenda zonës së kontraktuar.
- b. Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike)si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga autoriteti kontraktues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij,ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të autoritetit kontratues.
- c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen çdo vit nga autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit. 2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse. 4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

- d. Grafikët për largimin e mbeturinave që do të paraqiten për miratim, duhet të pregatiten në mënyrë të tillë që të gjitha punimet të kryhen brenda orëve të natës, duke filluar jo më parë se ora 22.00, me qëllim që në orën 7.00 zona e kontraktuar të jetë krejtësisht e pastër. Ndryshimet në orarin e operimit dhe përfundimit të shërbimit në zonë, do të pranohen vetëm për shkak të pamundësisë objektive të kryerjes së shërbimit të parashikuar si dhe në rastet e ndryshimit të orarit për rrugët tregtare, por gjithmonë pasi të jenë verifikuar dhe miratuar zyrtarisht nga autoriteti kontratues, ndryshimet në grafikun e punimeve.

e. Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

f. Në rast se për arsye objektive nuk arrihet vendosja e planifikuar e numrit të konteinerëve dhe e pikave të grumbullimeve të mbetjeve, shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve do të shpeshtohet në funksion të sasise së depozituar të mbetjeve por gjithmone duke mos kaluar parashikimin kontraktual dhe preventivin e punimeve.

RRREGULLA PËR TU ZBATUAR

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth konteinerëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit të shërbimit dhe do të vendosen penalitete sipas parashikimit në nenin “gjopa dhe penalitetet”.

b. Operatori i shërbimit ka për detyrë të kryejë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane që depozitohen në ambjente publike brenda zonës së kontraktuar edhe në rast se hidhen larg pikave të miratuara të grumbullimit të tyre. Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së konteinerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

c. Operatori i shërbimit duhet të informojë me shkrim autoritetin kontratues në mënyrë periodike për të gjitha kontratat private të pastrimit që do ketë me të tretë, të reklamojë numrin e mjeteve dhe punëtorë shtesë për këto shërbime për të garantuar cilësinë e kërkuar të shërbimeve në kontratën me autoritetin kontratues.

d. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “zyrë të kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur 7 ditë të javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatorit të shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

e. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar të makinerive, pajisjeve.

f. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve të transportit dhe shoferëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

g. Në asnjë rast nuk duhet të kryhet largimi i mbeturinave urbane nga kontenierët në akset kryesore, pasi të jetë kryer fshirja dhe pastrimi i rrugëve ku ndodhen. Në të kundërt operatori i shërbimit duhet kryejë përsëri zbrazjen e kontenierëve pa shpenzime ose duhet të përdorë mjete shtesë për të garantuar që kontenierët të jenë bosh pas përfundimit të të gjitha shërbimeve të pastrimit.

h. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballë me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

- MJETET DHE PAJISJET

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:

7. Disponimi i mjeteve te meposhtme:

Lloji i Makinerive

Sasia

Pronesia

- | | | |
|---|---------------|-------------------------------|
| 1. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standard euro 5 | <u>cope 2</u> | <u>në pronesi ose me qera</u> |
| 2. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, me standard euro 5 | <u>cope 2</u> | <u>në pronesi ose me qera</u> |
| 3. Autobot uji | <u>cope 1</u> | <u>ne pronesi ose me qera</u> |

- Operatori duhet të paraqesë kontratë qiraje,ose pronësinë, të një lavazhi të licensuar , për larjen e koshave të pastrimit të paktën 1 herë në muaj dhe mjeteve të pastrimit,cdo ditë.
- Me afat sa afati i tenderit .

-Të gjitha makineritë teknologjike që do përdoren për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve të përcaktuara në kapitullin “specifikimet teknike”, pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit.

- RREGULLA TË TJERA PËR MJETET DHE PAJISJET:

- a.** Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga autoriteti kontraktues për gjendjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.
- b.** Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga autoriteti kontraktues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt.
- c.** Automjetet e largimit të mbeturinave duhet të lahen dhe dezinfektohen çdo ditë pas përfundimit të punës.
- d.** Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegiesh, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik ose estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga autoriteti kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penalitete.
- e.** Operatori i shërbimit duhet të vërë në përdorim emrin e tij për korespondencën e përbashkët, lidhjen telefonike, shenjat dhe targat e makinave.

- MIRËMBAJTJA E VENDGRUMBULLIMEVE TË MBETJEVE GJATË DITËS

- Metodologjia e punës dhe rregulla për zbatim.

Shërbimi i mirëmbajtjes së pikave gjatë ditës dhe grumbullimi i mbetjeve, konsiston në:

a. Mirëmbajtjen dhe pastrimin gjatë ditës të mbetjeve urbane të hedhura dhe depozituara jashtë kontenierëve dhe të mbetjeve urbane voluminoze (ambalazhe) që tejmbushin artificialisht kontenierët dhe pengojnë mbetjet e tjera urbane për t'u depozituar nëpër kontenierë, në mënyrë që të gjitha pikat dhe kontenierët të jenë të pastër në vazhdimësi gjatë gjithë ditës. Nuk ka kufizime në pastrimin e sipërfaqes rreth kontenierit dhe operatori i shërbimit është i detyruar të largojë çdo mbetje urbane në të gjithë zonën e kontraktuar sado larg kontenierit të jetë hedhur.

b. Ky shërbim kryhet me anë të mjeteve vetëshkarkuese të vogla dhe të hapura që qarkullojnë nëpër të gjitha pikat e grumbullimit të zonës së kontraktuar për të mbledhur dhe larguar çdo papastërti që hidhet dhe depozitohet jashtë kontenierëve. Sipas nevojave që mund të ketë çdo pikë mund të jetë e nevojshme pastrimi disa herë në ditë të pikave dhe kontenierëve mbi të cilët në vazhdimësi ndotet gjatë orëve të ndryshme të ditës.

c. Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e këtij shërbimi, pregatiten nga sipermarrësi dhe miratohen çdo vit nga autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë: 1. Oraret e operimit në secilën vendgrumbullim mbetjesh. 2. Llojin, targën dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin. 3. Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse. 4. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

d. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

e. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

f. Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbetje urbane, ndërtimore, të vëllimshme dhe sipërfaqe rreth tyre të papastruara. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë ora e njoftimit apo konstatimit të problemit. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të vendosen penalitete.

g. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë (ose natë) në punë, minimalisht numrin e kërkuar dhe deklaruar të makinerive dhe pajisjeve dhe punëtorë për kryerjen me cilësi të këtij shërbimi.

h. Nëqoftë se gjatë transportit derdhen papastërti nga makinat e shërbimit, brenda ose jashtë zonës së shërbimit, ato duhet të pastrohen menjëherë. Në të kundërt përveç shpenzimeve që duhet të përballojë kontraktori për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të rëna gjatë transportit, ai do të përballlet me penalitetet e parashikuara në përputhje me këtë kontratë apo me gjopa të tjera në përputhje me ligjet dhe vendimet në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

i. Përdorimi i uniformave për punëtorët që kryejnë shërbimin e pastrimit është rigorozisht i detyrueshëm dhe në rast mosbatimi aplikohen gjopa për mosplotësim këtij detyrimi.

FSHIRJA E RRUGËVE DHE TROTUAREVE ME KRAHË.

- VOLUMET E PUNIMEVE

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht sheshet, rrugët, trotualet dhe sipërfaqet e tyre për të gjithë zonën e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të fshijë me krah edhe do të kryejë të gjitha shërbimet e tjera mbështetëse parashikuar në metodologji për të gjitha rrugët dhe trotualet e përcaktuara, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe të përgjithshme prej **111,923 m²** këto janë parashikuar në listën e

rrugëve dhe volumet e tyre për shërbimin e fshirjes për qytetin e Shijakut dhe Njesive Administrative.

- SPECIFIKIME TEKNIKE DHE METODOLOGJIA

Shërbimi i fshirjes së rrugëve dhe trotuareve me krahë konsiston në:

- a.** Fshirjen me punëtorë me fshesë të gjithë rrugëve kryesore, shesheve dhe trotuareve.
- b.** Fshirjen dhe pastrimin me punëtorë pastrimi të gjitha segmenteve të zëna nga parkimi, trotuareve, dhe rrugëve.
- c.** Proçesit të fshirjes dhe pastrimit i nënshtrohen të gjitha rrugët dhe trotualet e parashikuara në zonën e kontraktuar (të asfaltuara, si dhe trotualet e qytetit).

- PLANI I PUNËS DHE GRAFIKËT E PUNIMEVE

- a.** Fshirja e rrugëve do të bëhet gjatë natës dhe dites.
- b.** Për pastrimin e rrugëve të pandriçuara autoriteti kontratues mund të ndryshojë dhe miratojë grafikun dhe oraret e shërbimit, pas kërkesës të njëjës palë, për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
Këtu mund të përfshihen edhe rrugët brenda blloqeve të banimit apo rrugët dytësore që kanë lehtësi pastrimi gjatë ditës nga mungesa e parkimit.
- c.** Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zones, përgatiten nga sipërmarresi dhe miratohen çdo vit nga autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, vetëm për shkak të pamundësisë së kryerjes apo në rastet e ndryshimit të parkimit të makinave për rrugë të veçanta dhe ditë të veçanta dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga autoriteti kontratues këto ndryshime.
- d.** Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:
 - 1. Oraret e operimit në secilën rrugë dhe trotuar.
 - 2. Numri i punëtorëve që do të punojnë në çdo operacion punimesh.
- e.** Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
- f.** Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

- RREGULLA PËR TU ZBATUAR

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen rrugë të papastruara apo mbeturina të pa larguara në to. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të pastrohen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 3 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të penalizohet .

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “zyrë të kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve dhe pajisjeve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të shërbimit.

d. Për raste të veçanta operatori i shërbimit është i detyruar të fshijë rrugët më shumë se një herë pa shpenzime.

e. Gjatë procesit të fshirjes i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse (Erzen), zonat e gjelbërta, në banesat ujore natyrore apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimi të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballë me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

g. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoka për mosplotësim të tyre.

h. Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj siç është përcaktuar në nenin 2 ”përkufizimet”.

- MJETET DHE PAJISJET

Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me krahë të rrugëve dhe trotuareve si dhe të gjitha shërbimeve plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:

- a. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune pastrimi si fshesa plastike, lopata, karroca dore për të mundësuar kryerjen me cilësi të shërbimit.
- b. Pajisjet dhe veglat e punës të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë. Punëtorët e fshirjes duhet të jenë të pajisur: me fshesa, , lopata, karroca dore.

III -MIRMBAJTJE E DRUREVE DEKORATIVE , SIPERFAQEVE TE GJELBERTA DHE SHATERVANEVE

- VOLUMI I PUNIMEVE

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht mirëmbajtjen e drureve me lartësi 1.5 m, 1920 cope, sipërfaqeve me bar dekorativ dhe sipërfaqeve me lule dekorative, dhe 2 shatervaneve me sip 25 m2 dhe 150 m2 ne qytetin e Shijakut dhe Njësive Administrative nga ora 7.00 deri 15.00 .

-SPECIFIKIME TEKNIKE DHE METODOLOGJIA

a. Shërbimi i mirëmbajtjes se sip te gjelberta, konsiston në:

Mirëmbajtjen me punëtorë gjatë ditës të sipërfaqeve me drure, lule dhe bare dekorativ , duke i punuar dhe sherbyer me te gjitha proceset e nevojshem,si ujitje,krasitje,nderrim i plehut,mbjellje ne rast demtimi etj.

b. Shërbimi i mirëmbajtjes se shatervaneve, konsiston në mirëmbajtjen me punetore te shatervaneve, pastrimin e tyre me furça perkatese ,zevendesimin e ujit te ndotur me uje te paster pas cdo larje si dhe riparime ne rastye defektesh te pompave te ujit apo cfaredo lloj defekti tjeter.

- PLANI I PUNËS DHE GRAFIKËT E PUNIMEVE

a. Mirëmbajtja e sipërfaqeve te gjelberta dhe shatervaneve do të bëhet gjatë ditës nga ora 7.00 deri 15.00.

b. Mirëmbajtja do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga autoriteti kontratues.

c. Grafikët e punimeve per realizimin e shërbimit, pregatiten nga sipërmarresni dhe miratohen çdo vit nga autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga autoriteti kontratues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktoheh saktë: 1. Oraret e operimit. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

- RREGULLA PËR TU ZBATUAR

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen peme, apo sip me bare e lule te thara, te prishur e te demtuara, apo shatervane te ndotura apo mosfunksionim te tyre në të gjitha rastet kur evidentohen pengesa

nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të kryhet mirmbajtja me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa. Në rast të kundërt përgjegjësia është e operatori i shërbimit dhe do të penalizohet .

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “zyrë të kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00 . Përfaqësues të operatori i shërbimit duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet e qytetarëve dhe autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

d. Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujërave të zeza, në zgarat e pusetave të ujërave atmosferike, në shtretërit e ujërave rrjedhëse (Erzen), zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj.

e. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t’i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrimit të tyre brenda 5 orë nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballat me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

f. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjopa për mosplotësim të tyre.

MJETET DHE PAJISJET

1. Çdo punëtorë duhet të jetë i pajisur me mjete pune mirmbajtje si, shkalle, gershere, bel, karroce dore, e mjete te tjera.

V- SHERBIMI I VARRIMIT DHE MIRMBAJTJA E VARREZAVE

- VOLUMI I PUNIMEVE

Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht shërbimin e varrimit dhe te mirmbajtjes se varrezave përgjate gjithë vitit ne zonen e kontraktuar.

Operatori i shërbimit do të mirëmbajë të gjitha sipërfaqet e varrezave dhe do te ofroje shërbimin e varrimit, në zonën që do të kontraktohet, në një sipërfaqe prej **204,441 m²**, nga ora 7.00 deri 15.00.

Këto janë parashikuar në listën për shërbimin e varrimit për qytetin e Shijakut dhe Njësi Administrative.

SPECIFIKIME TEKNIKE DHE METODOLOGJIA

Shërbimi i mirëmbajtjes së varrezave dhe pastrimit, konsiston në:

Mirëmbajtjen dhe pastrimin me punëtorë gjatë ditës të varrezave, heqjes së barishteve përreth, dhe mbeturinave të vogla që lenë qytetaret, si dhe shërbimit të hapjes së varrit në raste vdekjesh.

-PLANI I PUNËS DHE GRAFIKËT E PUNIMEVE

a. Mirëmbajtja e sipërfaqes së varrezave do të bëhet gjatë ditës nga ora 7.00 deri 15.00

b. Mirëmbajtja dhe shërbimi i varrimit do të kryhet sipas grafikëve të miratuar nga Autoriteti kontraktues.

c. Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit, përgatiten nga sipërmarrësi dhe miratohen çdo vit nga autoriteti kontraktues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime në orën e operimit dhe përfundimit të shërbimit, sa herë lind e nevojshme edhe brenda një viti, dhe gjithmonë pasi të jenë miratuar zyrtarisht nga Autoriteti kontraktues këto ndryshime.

d. Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohet saktë: 1. Oraret e operimit. 2. Numrin e punëtorëve që do të punojnë.

e. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.

f. Autoriteti kontraktues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar nga kjo kontratë si dhe për të vendosur penalitete, gjoba dhe ndalesa për mospërmbushjen e tyre.

RREGULLA PËR TË ZBATUAR

a. Për asnjë rast nuk do të lejohen sipërfaqe të papastruara apo demtime të varreve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm të cilat nuk mund të kryhen me operacionet e parashikuara në metodologji, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë në rast të kundërt përgjegjësia është e operatorit i shërbimit dhe do të penalizohet.

b. Operatori i shërbimit duhet të ketë në efikasitet një “zyrë të kontaktimit” për marrjen e ankesave e cila duhet të jetë e hapur në të gjithë ditët e javës nga ora 7.00-20.00. Përfaqësuesi i operatorit i shërbimit duhet të jetë prezent gjatë gjithë kohës së parashikuar për të marrë vërejtjet

e qytetarëve dhe autoritetit kontratues dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve të prezantuara brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit.

c. Operatori i shërbimit detyrimisht duhet të ketë çdo ditë në punë minimalisht numrin e punëtorëve sipas numrit të deklaruar në ofertën e tenderit për të garantuar kryerjen me cilësi dhe në kohë të këtij shërbimi.

d. Gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe pastrimit gjatë ditës të varrezave i ndalohet kategorikisht hedhja e mbeturinave në pusetat e elektrikut, telefonisë, të ujësjellësit, ujrave të zeza, në zgarat e pusetave të ujrave atmosferike, në shtretërit e ujrave rrjedhëse (erzen), zonat e gjelbra, në banesat ujore natyrale apo artificiale, etj. Në rast të konstatimit të kësaj dukurie operatori i shërbimit detyrohet t'i pastrojë menjëherë. Në rast të përsëritjes apo mospastrim të tyre brenda 5 orësh nga marrja e njoftimit, përveç përgjegjësisë së mbartjes së shpenzimeve përballet me penalitete sipas kësaj kontrate dhe ligjeve e vendimeve në fuqi për ndotjen e shkaktuar.

e. Përdorimi i uniformave për punëtorët është rigorozisht i detyrueshëm dhe do ndërmerren gjoka për mosplotësim të tyre.

f. Nën termin papastërti nënkuptohen të gjithë mbeturinat si: rërë, xham, letër, gurë, shishe, materiale organike, etj”

MJETET DHE PAJISJET

1. Çdo punëtor duhet të jetë i pajisur me mjete pune si, karroca dore, lopata, kosa, sepata etj për të mundësuar kryerjen e shërbimit.

Gjatë zbatimit të kontratës, Bashkia Shijak do t'i prezantojë për çdo rast kontraktuesit realitetin e ri të sipërfaqeve dhe shërbimeve që vjen si rrjedhojë e investimeve të kryera në infrastrukturën tokësore.

GRUPI I PUNES

• Ismail Gjergji	Kryetar
• Taulant Xheraj	Anëtar
• Astrit Remilli	Anëtar
• Brusi Vora	Anëtar
• Bledar Dervishi	Anëtar
• Ruzhdi Shehi	Anëtar
• Helidon Kalleshi	Anëtar
• Elona Tikvina	Anëtar
• Merushe Cali	Anëtar
• Enxhi Lila	Anëtar